

UDHËZIM
Nr. 31, datë 13.9.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 21.5.2018 “PËR
PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT
TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER
PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË,
NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2018–2019”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, dhe pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015
“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”

UDHËZOJ

1. Germat “a” dhe “b”, të pikës 14, të kreut “Kreu IV/3”, të udhëzimit nr. 18, datë 30.7.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ndryshojnë si më poshtë:

“a) Zhvillimi i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, të kandidatëve me diploma të huaja të shkollës së mesme, në programet e studimit objekt të këtij udhëzimi, në LAL-të që i zhvillojnë këto programe, si programe të përbashkëta studimi, që përfundojnë me një diplomë të përbashkët, të dyfishtë ose të shumëfishtë, në bashkëpunim me LAL-të e vendeve të BE-së, kryhet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuar nga vetë LAL-të.

“b) Njohja e dokumentacionit të kandidatëve të pajisur me diploma të huaja të shkollës së mesme, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen pajisjen e tyre me NIM dhe brenda muajit janar 2019 ia komunikon zyrtarisht LAL-së”.”

2. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, DAR/ZA-të, si dhe IAL-të, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla**